

UDHËZIMET E PËRMBAJTJES SË BBM CHANNELS

Ju lutemi kini parasysh se udhëzimet e mëposhtme nuk kanë si qëllim të jenë këshilla ligjore dhe zbatimi i këtyre udhëzimeve nuk tregon domosdoshmëri përputhje ligjore. Ne rezervojmë të drejtën të largojmë çdo përmbajtje e cila, vetëm sipas mendimit tonë të lirë, shkel këto udhëzime ose me fjalë të tjera shihet si e papërshtatshme.

1. Të përgjithshme.

- a. Ju jeni plotësisht përgjegjës për të siguruar që postimet, reklamat dhe promocionet tuaja (së bashku, "Përmbajtja") të përputhen me të gjitha ligjet e zbatueshme, rregullat, udhëzimet dhe kodet e industrisë.
- b. Pa kufizuar çka është thënë më lart, nëse përmbajtja juaj synon vetëm përdoruesit e një moshe të caktuar ose më të mëdhenj, apo që banojnë në një juridiksion të veçantë, dhe nëse mosha ose juridiksioni i një përdoruesi nuk mund të përcaktohet, ju nuk mund t'ia shfaqni përmbajtjen tuaj këtij përdoruesi. Megjithëse ne mund të sigurojmë kontrolle të cilat ndihmojnë me këtë gjë, ne nuk bëjmë ndonjë përfaqësim në lidhje me mjaftueshmërinë e kontrollit të dhënë, dhe në fund të fundit ju jeni përgjegjës për të vendosur kushtëzime të përputhshme ligjore për çdo vend ku shfaqet përmbajtja juaj.
- c. BBM Channels kanë si qëllim që t'i lejojnë administratorët e Kanalit të postojnë dhe shfaqin përmbajtje e cila është e përshtatshme për markën, organizatën, ngjarjen ose individin e paraqitur në Kanal. Një Kanal nuk mund të përdoret për të paraqitur reklama të palës së tretë dhe ju nuk mund të merrni me qira afatshkurtër ose afatgjatë ose me fjalë të tjera ta bëni Kanalin tuaj të mundshëm për qëllime të tilla.
- d. Përmbajtja nuk mund të jetë e rreme, mashtruese, hileqare ose zhgënjyese në natyrë ose përmbajtje.
- e. Nëse përmbajtja juaj përfshin një lidhje me një faqe interneti, produktet dhe shërbimet e reklamuar në përmbajtje duhet të paraqiten qartësisht në faqen kryesore të një faqeje të tillë interneti dhe lidhja nuk duhet të çojë në një faqe mashtruese, programi të keq apo tek ndonjë kod ose faqe tjetër e dëmshme, apo tek ndonjë faqe nga e cila përdoruesit nuk mund të dalin lehtësisht.
- f. Përmbajtja nuk mund të dhunojë ose cenojë të drejtat e palës së tretë, përfshirë të drejtën e autorit, markës së fabrikës, privatësinë, publicitetin ose pronësi të tjera intelektuale ose të drejtat e pronarit.
- g. Përmbajtja nuk duhet të përfshijë reklama ose lidhje me përmbajtjen e palëve të treta me qëllim krijimin e të ardhurave nga partnerizimi ose forma të tjera të marketingut të bazuar në efektshmëri.
- h. Përmbajtja nuk mund të sugjerojë ndonjë lidhje ose partnerizim me BlackBerry apo ndonjë nga kompanitë tona partnere, pa autorizimin tonë ose të tyre të paraqitur me shkrim.

2. **Përmbajtja e Kufizuar.** Përmbajtja nuk mund të përfshijë ose të reklamojë ndonjë nga gjërat e mëposhtme:
- a. Përmbajtje për të rriturit, duke përfshirë revista, libra, imazhe, filma për të rriturit apo pornografikë, ose materiale të tjera që tregojnë lakuriqësi, lakuriqësi të pjesshme apo përmbajtje seksuale.
 - b. Urrejtje, cenim, presion ose përmbajtje diskriminuese, përfshirë:
 - i. Mos përkrahje e një individi ose grupi të mbrojtur duke u bazuar në racën ose origjinën etnike, ngjyrën, origjinën kombëtare, besimin fetar, lidhjet politike, paaftësia, mosha, statusi i veteranit ose orientimi seksual/identiteti i gjinisë;
 - ii. Dhunë kundër njerëzve ose kafshëve, ose dëmtim të vetvetes apo përmbajtje që ka të bëjë me këto gjëra;
 - iii. Organizata ose individë të cilët nxisin urrejtje, akte ose përmbajtje kriminale apo të lidhura me terrorizmin; ose
 - iv. Presion dhe ngacmim, të tilla si postime të shpeshta, me qëllim e të padëshiruara dhe komente të përqendruara tek një individ.
 - c. Alkool, duhan, armë ose bixhoz, me përjashtim të rasteve kur lejohet nga ligji i zbatueshëm, e vetëm në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe kodet e industrisë, udhëzimet, licencat e aprovimet, dhe vetëm nëse një Përmbajtje e tillë mund të kufizohet për përdoruesit e një moshe dhe juridiksioni të kërkuar.
 - d. Droga ilegale ose çlodhëse apo pajisje shtesë të drogës.
 - e. Produkte ose shërbime ilegale, ose produkte dhe shërbime që dhunojnë të drejtat e palës së tretë apo privatësinë ose të dhëna të tjera të zbatueshme të mbrojtjes së të drejtave të një individi.
 - f. Programe që përmbajnë plotësisht ose pjesërisht programe spiunuese ose të dëmshme, apo që rezultojnë në një eksperiencë të papritur, mashtruese ose të padrejtë të përdoruesit.